



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3098/8 Prot.

Patos më 17.10.2025.

PROCESVERBAL

MBI MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS SË MBLEDHJES SË DATËS 15.10.2025

I mbajtur sot më datë 15.10.2025 në orën 15:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit ku zhvillohet mbledhja e Këshillit të Bashkisë:

Prezent në fillimin e mbledhjes këta këshilltarë:

1. Albiona Lamaj
2. Klaudio Alisinanaj
3. Liljana Mesutaj
4. Erald Çepele
5. Lori Musaj
6. Artan Velçani
7. Klarida Semanjaku
8. Armand Ahmetaj
9. Ertilla Myrtaj
10. Suela Hoxha
11. Smerald Hazizaj
12. Elmira Rama
13. Renaldo Shpata
14. Vjollca Kasaj
15. Novrus Toska
16. Adile Alushaj

Takimi hapet nga kryetari i Këshillit z. Armand Ahmetaj.

Armand Ahmetaj – Përshëndetje të gjithëve!

Të nderuar këshilltarë!

Jemi në këtë mbledhje të këshillit jashtë radhe e kërkuar nga kryetari i bashkisë me urdhër dhe delegim zëvëndësi i tij znj. Ina Sauli. Kërkesa mban nr. 3098 prot Patos datë 14.10.2025. Mbledhja e sotme bazohet në nenin 53 pika 3 gërma “a” të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, të nenit 59 të “Rregullores për Organizimin dhe Funkcionimin të Këshillit Bashkiak”, Pjesëmarrja në mbledhjen e këshillit është 16 këshilltarë.

Vazhdojmë me leximin e rendit të ditës.

- 1- Miratimi i rendit të ditës.
- 2- Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 22.09.2025.
- 3- Informacion mbi vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 22.09.2025.
- 4- Projekt-vendim për ndryshim të vendimit të këshillit bashkiak nr. 87, datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit për vitin 2025 së bashku me numrin e përgjithshëm të punonjësve, dokumentin përfundimtar të projektbuxhetit afatmesëm 2025-2027”.
- 5- Projekt-vendim “Për miratimin e nivelit të pagave në Bashkinë Patos ndërrmarjeve në varësi për vitin 2025 dhe 2026”.
- 6- Projekt-vendim “Për mbylljen e njësisë shpenzuese” Agjencia e Shërbimeve Publike”.
- 7- Projekt-vendim “Për krijimin e njësisë shpenzuese të emërtuar “ Ndërrmarja e Shërbimeve Publike në varësi të Bashkisë Patos”.
- 8- Projekt-vendim “Për krijimin e njësisë shpenzuese të emërtuar “Ndërrmarja e menaxhimit të mbetjeve, pastrimit dhe gjelbërimit” në varësi të Bashkisë Patos”.

Armand Ahmetaj-Paraprakisht dua tju informoj se ka një kërkesë nga ekzekutivi që çështja e cila është renditur në rendin e ditës me numër rendor pesë do të shqyrtohet në një moment tjetër. Do tja kaloj fjalën përfaqësuesve të ekzekutivit për ta sqaruar më tej pse do tërhiqet nga kjo pikë.

Juela Shpata – Drejtore e Burimeve Njerezore- Përhëndetje të gjithëve! I kërkojmë këshillit të bashkisë Patos të tërhiqemi nga miratimi i Projekt-vendim nr. 61 “Për miratimin e nivelit të pagave në Bashkinë Patos ndërrmarjeve në varësi për vitin 2025 dhe 2026”, pasi gjatë muajit nëntor kemi parë të arsyeshme për të parë dhe rivlerësuar dhe njëherë të ardhurat dhe burimet për të miratuar nivelin e pagave të vitit 2026 në një moment të dytë.

Armand Ahmetaj- Atëherë kemi ndonjë propozim për të shtuar apo për të hequr?

Armand Ahmetaj- Kush është dakord me rendit e ditës? 17 vota ju njoftoj se është shtuar prezenca në sallë me Z. Gani Ahmetaj

Miratohet me 17 vota pro, asnjë abstenim, asnjë kundër.

SEKRETARE


Refaela Xeba



Smerdal Hoxhaj
Adile Alustaj
Artan Deloani

KRYETAR

Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3098/9 Prot.

Patos më 12.10.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 15.10.2025 në orën 15:00 në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së dytë të rendit të ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 22.09.2025

Armand Ahmetaj – Materialin jua ka dërguar sekretarja, nëse keni ndonje pyetje, propozim, korrigjim?

Nese skemi gjë tjetër konsiderohet i miratuar.

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR
Armand Ahmetaj

Adile Alushaj
Artan Velami



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3098/10 Prot.

Patos më, 14 10.2025

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 15.10.2025 ora 15:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së tretë të rendit të ditës.

Mbi informacionin për vendimet e miratuara në mbledhjen e datës 22.09.2025

Armand Ahmetaj– Fjala për Refaelën
Refaela Xeba -Përshëndetje të gjithëve!

Në mbledhjen e datës 22.09.2025 u morën gjithsej 8 vendime nga nr. 55 deri në 62.

Vendimet janë zbardhur në afat dhe i janë përcjell drejtorive përkatëse për ekzekutim.

Nga këto vendime vendimi me nr. 59 dhe 61 i janë përcjell Prefekturës për verifikim të ligjshmërisë dhe na ka ardhur përgjigja se vendimet janë në përputhje me ligjin.

Faleminderit!

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3093/3 Prot.

Patos më 17 10.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 15.10.2025 në orën 15:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së katërt të rendit të ditës.

Projekt-vendim për ndryshim të vendimit të këshillit bashkiak nr. 87, datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2025 së bashku me numrin e përgjithshëm të punonjësve, dokumentin përfundimtar të projektbuxhetit afatmesëm 2025-2027".

Juela Shpata – Drejtore e Burimeve Njëzore- Ekzekutivi paraqet projektvendimin nr. 60 për ndryshim të vendimit të këshillit bashkiak nr. 87, në të cilin është miratuar niveli i pagave së bashku me Pba 2025-2027.

Për të përmirësuar ciësinë e shërbimit ndaj qytetarëve për të patur një menaxhim efektiv të të gjitha fushave dhe pergjegjësi të bashkisë Patos për një hierarki më të qartë dhe për më shumë efektivitet, për një nënveprim midis drejtorive dhe njësive vartëse është parë e nevojshme dhe domosdoshme të shikohet edhe njëherë struktura e bashkisë Patos së bashku me institucionet në vartësi.

Tabela e cila është bashkëlidhur në relacion paraqet strukturën aktuale dhe strukturën e re në të cilën do të shtohen nëntë punonjës aktualisht jemi 371 dhe do të shkojmë në 380.

Legjislacioni i përmendur në projektvendim është i gjithë në fuqi. Kërkojmë miratimin.

Lori Musaj- Kryetare e komisionit të ekonomisë- Përhëndetje të gjithëve! Ju bëj me dije se komisioni ekonomisë u mbledh ditën e sotme dhe gjatë diskutimeve u vlerësua se ndryshimet e propozuara janë në përputhje me objektivat e bashkisë për një administratë më funksionale me ndarje më të qartë pergjegjësish dhe përdorim racional të burimeve njerëzore dhe buxhetore ,në këtë kuadër komisioni ekonomisë jep mendimin pozitiv duke votuar me katër vota pro për miratimin e strukturave të reja duke theksuar rëndësinë e zbatimit të këtyre me transparenca në përputhje me ligjin, ne besojmë se ky hap do të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të institucional dhe ofrimin e një shërbimi më të shpejtë dhe cilësor për qytetarë të Patosit. Faleminderit!

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë pyetje?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e katërt Projekt-vendim Projekt-vendim për ndryshim të vendimit të këshillit bashkiak nr. 87, datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2025 së bashku me numrin e përgjithshëm të punonjësve, dokumentin përfundimtar të projektbuxhetit afatmesëm 2025-2027".

Kush është dakord?

Miratohet me 17 vota pro, abstenim ska, kundër ska

SEKRETARE

Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3095 / 2 Prot.

Patos më 17 10.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 15.10.2025 në orën 15:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së pestë të rendit të ditës.

Projektvendim “Për mbylljen e njësisë shpenzuese “Agjencia e Shërbimeve Publike”.

Boreta Murati – Drejtore e Planifikimit Urban - Agjencia e Shërbimit Publik është krijuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë me nr. 68, datë 14.12.2021 me qëllim kryesor ofrimin e shërbimeve publike bazë si pastrimi, mirëmbajtja e gjelbërimit, ndricimit publik dhe ndërhyrjet e vogla infrastrukturore.

Gjatë vitit të fundit nga analiza e funksionimit të saj është konstatuar se përfshirja e një numri të madh funksionesh të ndryshme brenda një strukture të vetme ka krijuar vështirësi në menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore, financiare dhe materiale.

Nga analiza e kryer janë konstatuar disa problematika konkretisht:

Përqëndrimi i lartë i funksioneve në një strukturë të vetme, pa ndarje të qartë të përgjegjësiive ndërmjet sektorëve;

Mungesë e efikasitetit në planifikimin buxhetor, pasi kostot e shërbimeve nuk pasqyrohen qartë sipas funksioneve specifike;

Vështirësi në matjen e performancës, për shkak se indikatorët e punës janë të përzier ndërmjet shërbimeve të ndryshme;

Mbivendosje kompetencash ndërmjet ASHP-së dhe drejtorive të tjera të bashkisë, duke krijuar pasiguri në ndarjen e përgjegjësiive;

Mungesë fleksibiliteti në drejtim të menaxhimit të personelit dhe shpenzimeve operative.

Arsyeja dhe qëllimi i mbylljes së ASHP-së është në funksion të rritjes së efikasitetit dhe transparencës në përdorimin e fondeve publike. Mbyllja e kësaj njësie dhe krijimi i dy njësive të reja shpenzuese do të mundësojnë;

Ndarje të qartë të funksioneve dhe përgjegjësiive

Përmirësim i menaxhimit buxhetor, me llogaritje të sakta të kostove për çdo shërbim publik;

Rritjen e cilësisë së shërbimeve publike për qytetarët.

Për sa më sipër në mbështetje të nenit 54 shkronja “d” dhe nenit 64 shkronja “c” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 87,

datë 19.12.2024, “Mbi miratimin e buxhetit për vitin 2025 së bashku me numrin e përgjithshëm të punonjësve, dokumentit përfundimtar të projekt buxhetit afatëmesëm 2025-2027”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 83, datë 27.11.2024 “Për miratimin e nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve në vartësi dhe të Njësive Administrative për vitin 2025”, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

Të miratojë mbylljen e “Agjencia e Shërbimeve Publike” si njësi shpenzuese dhe krijimin e dy njësive shpenzuese të reja. Si fillim kemi mbylljen e Agjencisë.


Artan Velçani – Kryetari i Shërbimeve Publike - komisioni i shërbimeve Publike mori parasysh këtë projektvendim dhe ashtu edhe nga konsideratat që tha inxhinieria Bora vlerësoi edhe nga pikëpamja e ligjshmërisht dhe mbështet propozimin e ekzekutivit për shkrihimin e agjencisë dhe krijimit ndërmarrjeve të tjera.

Armand Ahmetaj- Keni ndonjë propozim, kush e do fjalën ?

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e pestë Projekt-vendim “Për mbylljen e njësive shpenzuese” Agjencia e Shërbimeve Publike”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord për miratimin?
Miratohet me 17 vota pro, abstenim ska, kundër ska.


SEKRETARE
Refaela Xeba



Adile Alushaj

Artan Velçani

KRYETAR
Armand Ahmetaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 3096/3 Prot.

Patos më 17.10.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 15.10.2025 në orën 15:00,, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së gjashtë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për krijimin e njësisë shpenzuese të emërtuar “Ndërrmarja e Shërbimeve Publike në varësi të Bashkisë Patos”.

Boreta Murati – Drejtore e Planifikimit Urban- Në vijim të kërkesës së Agjencisë së Shërbimeve Publike për ndarjen e Agjencisë së Shërbimeve Publike për shkak të funksioneve të shumta që Agjencia e Shërbimeve Publike kishte është krijuar një ngarkesë në një mbivendosje funksionesh për njësi të vetme dhe për një shpërndarje më të mirë të detyrave funksionale dhe zgjidhje sa më efektive të detyrave të caktuara u pa e nevojshme krijimi e dy njësive ku një njësi e re shpenzuese siç është ndërrmarja e shërbimeve Publike është krijuar me qëllim kryesor menaxhimin e shërbimeve komunale dhe publike të bashkisë, sigurimin e cilësisë dhe vazhdmisisë së këtyre shërbimeve, krijimin e një strukture më të qartë dhe efektive në përdorimin e fondeve buxhetore si dhe forcimin e kontrollit financiar dhe të përgjegjshmërisë institucionale.

Kjo ndërrmarje do të ketë si numër të përgjithshëm punonjësish 65 dhe do të mundësoj një menaxhim më të mirë të burimeve njerëzore, rritjen e kontrollit dhe menaxhimin më të mirë.

Kerkojmë miratimin e krijimit të njësisë shpenzuese të emërtuar “Ndërrmarja e shërbimeve publike” e cila do të jetë në varësi të bashkisë Patos.

Artan Velçani- Kryetari i Shërbimeve Publike – edhe kjo çështje edhe projektvendimi për ndërrmarjen tjetër kanë kaluar në komision me shumicë votash unë doja të ndaja një opinion në emër të këshilltarëve besoj që shërbimet ashtu siç parashikon dhe ekzekutivi do të jenë sa më cilësore dhe më të mira.

Armand Ahmetaj –Nëse s’kemi pyetje të tjera unë propozoj ta kalojmë në votim pikën e gjashtë Projekt-vendim “Për krijimin e njësisë shpenzuese të emërtuar “Ndërrmarja e Shërbimeve Publike në varësi të Bashkisë Patos”.

Kush është dakord?

Miratohet me 17 vota pro, ska kundër , abstenim ska.

SEKRETARE
Refaela Xeba

KRYETAR

Armand Ahmetaj

Adile Alushaj
Artan Velçani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË PATOS

Nr. 30981 / 13 Prot.

Patos më 17 10.2025.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot më datë 15.10.2025 në orën 15:00, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak, mbi shqyrtimin e pikës së shtatë të rendit të ditës.

Projekt-vendim “Për krijimin e njësisë shpenzuese të emërtuar “Ndërrmarja e menaxhimit të mbetjeve, pastrimit dhe gjelbërimit” në varësi të Bashkisë Patos”.

Boreta Murati – Drejtore e Planifikimit Urban - qëllimi kryesor për këtë njësinë e re shpenzuese do të jetë menaxhimi i shërbimeve komunale dhe publike të bashkisë kryesisht me menaxhimin e mbetjeve pastrimit dhe gjelbërimit në gjithë territorin tonë, kjo njësi e re shpenzuese do të ketë si qëllim kryesor menaxhimin sigurimet cilësisë dhe vazhdimësinë e këtyre shërbime krijimin e një strukture më të qartë më efektive të përdorim të fondeve buxhetore si dhe forcimin e kontrollit financiar dhe përgjegjshmërinë institucionale

Kjo ndërmarrje do të ketë sipas tabelës bashkëlidhur numrin e punonjësve që kam përshtypjen do të jetë 59 dhe do të mundësoj një menaxhim më të mirë të burimeve njerëzore, rritjen e kontrollit dhe menaxhimin më të mirë.

Për sa më sipër në mbështetje të ligjeve përkatës, i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Patos:

Krijimin e njësisë shpenzuese të emërtuar “Ndërmarrja e menaxhimit të mbetjeve, pastrimit dhe gjelbërimit” në varësi të bashkisë Patos

Artan Velçani- Kryetari i Shërbimeve Publike – Nuk kemi asgjë për të shtuar, shpresojmë që ajo që tha ekzekutivi të realizohet.

Albiona Lamaj - Atëhere duke parë gjithë pikat e rendit të ditës dhe duke parë dhe strukturën e re të Bashkisë Patos besoj që tani janë të ndara kompetencat për secilin dhe pas kësaj mbledhje të këshillit i takon bashkisë rregullorja e brendshme dhe ndarja e gjithë funksioneve që do të kenë secili prej prej këtyre sektorëve dhe drejtorive të reja përgëzime edhe vazhdon puna më tej dhe shpresoj shumë që kjo të përkthehet në një shërbim më cilësor ndaj qytetarëve.

Novrus Toska – Më vjen mirë që bashkia do të riorganizohet, ndihem mirë që këtu është rivendosur që ngrihet Drejtoria e Bujqësisë që për mua ka qenë një gabim që u shkri si drejtori dhe mendoj se më duket parasysh bashkia Patos në tërësi e saj është një bashki rurale bujqësore mendoj që kjo drejtori duhet të ketë peshën e vetë specifike në punë të bashkisë dhe interesin e saj Ju faleminderit!

Erald Çepele - dua të përgëzoj ekzekutivin por dhe këshillin dhe gjithë grupin që ka punuar kemi dhe ne si këshilltarë rolin tonë në këtë pjesë, gjithë pjesa e strukturës së re organizative bashkisë dhe lidhur edhe me dy ndërmarrje cila do krijohen gje e cila do sjelli një organizim më të mirë shërbime më cilësore për qytetarët por dhe shpejtësi në kryerjen e disa detyrave ose disa punëve publike të cilat kërkojnë zgjidhje për qytetarët sigurisht ngelen siç e tha dhe Albiona rregullorja të

përcaktoi qartë detyrat për secilin, struktura i ka të qarta për secilin specialist janë të ndara që nga Nënkryetarët detyrat, Sekretari Përgjithshëm në të gjitha radhë gjë e cila do të sjelli organizim më të mirë vetëm transparencë më të madhe dhe shërbimet shpejta kështu që ngelet dhe nga të gjitha administrata të punojnë përkushtim të kemi një rritje të ardhurave gjë e cila mos te na vëri vështirësi nesër për nivelin e pagave. Niveli i pagave nuk të ndryshojë, ska pse të ndryshojë edhe në vitin tjetër kështu që kjo do të jetë një mesazh që ta marin të gjithë.

Armand Ahmetaj- Jo mund ta ndryshojmë ne kemi frymën për të rritur pagat pse thua mos ta ndryshojmë.

Erald Çepele – po por prapë kemi dëgjuar lloj lloj kështu që ne kemi qenë ata që kemi votuar rritjen e pagave, të punojnë me seriozitet që të kemi mundësi të rrisim pagat akoma më shumë.

Armand Ahmetaj – Kalojmë në votim e pikës shtatë Projekt-vendim “Për krijimin e njësisë shpenzuese të emërtuar “Ndërrmarja e menaxhimit të mbetjeve, pastrimit dhe gjelbërimit” në varësi të Bashkisë Patos”.

Armand Ahmetaj –Kush është dakord?

Miratohet me 17 vota pro, abstenim ska, kundër ska.

SEKRETARE

Refaela Xeba



Smerolal Hoxha
Adile Alushaj
Artan Velkani

KRYETAR

Armand Ahmetaj

